

Të premten në Universitetin e Prishtinës është nënshkruar një marrëveshje për fillimin e dy programeve master

# UP ME DY PROGRAME TË REJA PËR MASTER

EPOKA  
ERE

LIRIJE KLAIQI

**Prishtinë, 29 maj** - Të premten në Rektoratin e Universitetit i Prishtinës (UP) është bërë nënshkrimi i kontratave për fillimin e dy programeve të reja të studimeve master në drejtimet në Menaxhim të Shëndetësisë (Fakulteti i Mjekësisë) dhe master në Mekatronikë, (Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike dhe Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike).

Me këtë marrëveshje, drejtimi master në Menaxhim të Shëndetësisë, që do të zhvillohet në Fakultet të Mjekësisë, do të ketë bashkëpunim binjakëzimi me Universitetin e Mjekësisë në Vjenë. Ndërsa që drejtimi tjetër Interdisiplinar në Mekatronikë, që do të zhvillohet në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike dhe në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, procesin e binjakëzimit do ta zhvillojë me Universitetin FH Joanneum të Grazit.

Në këtë kontekst Universiteti i Prishtinës, më specifisht Fakulteti i Mjekësisë, Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike dhe Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike duke zhvilluar proces binjakëzimi me Institucionet e Edukimit të Lartë të Austrisë do të kenë mundësi të fitojnë dhe shkëmbejnë përvaja të ndryshme në lëmin e mësimdhënies, mësimnxënies, hulumtimit dhe mbështetje të tjera që do të jenë të nevojshme për zhvillimin e këtyre dy drejtimeve të reja në mënyrë sa më efikase dhe me orientim nga kërkasat e tregut të punës.

Krijimi i këtyre dy drejtimeve të reja në nivelin master është mundësuar nga Programi për Zhvillim të Studimeve Master (MSDP), që implementohet nga

WUS Austria, Zyra në Prishtinë, dhe financohet nga Agjencia Austriake për Bashkëpunim (Austrian Development Cooperation).

Ky program përkrah fakultetet e interesuara të Universitetit të Prishtinës në zhvillimin e programeve master në bazë të nevojave të tregut të punës dhe kuadrot e të cilave janë më se të nevojshme për këtë treg në Kosovë. Ky program jep mundësinë e zhvillimit të kurrikulës së re në bashkëpunim me Institucionet e Arsimit të Lartë të Austrisë si dhe në bashkëpunim me institucione, organizata dhe biznese vendore. Prandaj, theks i veçantë i vihet përkrahjes strategjike në zhvillimin e programeve master, të cilat përqendrohen në 1) kërkasat e tregut të punës të cilat rezultojnë në zbatimin praktik të dijenisë, 2) bashkëpunimit me Institucionet e Arsimit të Lartë të Austrisë dhe 3) efekti i kthimit të trurit (Brain Gain). Qëllimi kryesor i këtij programi është ta lehtësojë tranzicionin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Kosovë në drejtim të përbushjes së standardeve Evropiane (Procesi i Bolonjës).

WUS Austria, me përkrahje financiare nga Agjencia Austriake për Bashkëpunim (Austrian Development Cooperation), do ta mbështesë zhvillimin dhe modifikimin e lëndëve të reja, krijimin e mundësive për konsultim me partnerët austriakë nepërmjet vizitave studimore, bashkëligjërim me kolegët austriakë, aktivitet trajnimi për profesorë, blerje të literaturës në fushat përkatëse, si dhe blerje të pajisjeve.

Programet e përkrahura do të zhvillohen në gjuhën angleze dhe pritet që këto dy drejtime të reja master të fillojnë në tetor të vitit akademik 2009/2010.

